

# LGJETJE MADHËSONI

Respektimi i  
parimeve për  
mbrojtjen e të  
dhënave personale





# UJËT NË MAGJEDOMI

---

**Respektimi i parimeve  
për mbrojtjen e të  
dhënave personale**

**Botues:**

**Metamorfozis, Fondacioni për internet dhe shoqëri**  
rr. Apostoll Gusllarot, nr. 40, 1000 Shkup  
www.metamorphosis.org.mk  
info@metamorphosis.org.mk  
tel./faks: +389 2 3109 325

**Për botuesin:**

**Bardhyl Jashari**

**Ekipi hulumtues:**

**Elena Stojanovska – hulumtues kryesor**  
**Bardhyl Jashari**  
**Filip Stojanovski**  
**Goce Arsovski**

**Përkthimi:**

**Marta Ziba**

CIP - Каталогизација во публикација  
Национална и универзитетска библиотека „Св. Климент Охридски“, Скопје

342.738:340.13(497.7)

LIGJET në Maqedoni : respektimi i parimeve për mbrojtjen e të  
dhënave personale / [Ekipi hulumtues Elena Stojanovska ... [и др.] ;  
përkthimi Marta Ziba]. - Shkup : Metamorfozis, 2015. - 43 стр. :  
граф. прикази ; 21 см

Библиографија: стр. 43. - Содржи и: Anekse

ISBN 978-608-4564-63-8

а) Заштита на лични податоци - Правна рамка - Македонија  
COBISS.MK-ID 100067338



# PËRMBAJTJA

* Rezime	6
* Hyrje	7
* Korniza ligjore për privatësinë	9
* Metodologjia e hulumtimit	11
* Rezultatet e analizës së qëndrimeve dhe mendimeve të ekspertëve	12
Rezultatet e anketimit të ekspertëve:	18
* Mbrojtja e të dhënave personale	21
* Analizë juridike e ligjeve	22
Metodologjia e analizës juridike	22
Rezultatet e analizës juridike të ligjeve	24
* Rekomandime nga hulumtimi	28
* Procedura për denoncimin e keqpërdorimit të të dhënave personale dhe shkeljes të të drejtës të privatësisë	34
* Anekse	35
Aneksi 1: Pyetësi për pjesëmarrësit në intervistë	35
Aneksi 2. Lista e ligjeve të analizuara me radhitje sipas alfabetit	37
Literatura e përdorur	38



Si përdorues të teknologjive të informacionit dhe komuniimit (TIK) gjatë komunikimit të përditshëm dhe në punë, privatësia është një nga sfidat më të mëdha me të cilën përballlemi. Me zhvillimin e shpejtë të TIK në një mënyrë dramatike ka ndryshuar mënyra në të cilën mblidhen, ruhen, qasja tek dhe shpërndarja e të dhënave personale. Pa dallim se për cilën fushë bëhet fjalë, qoftë për shëndetësi, mbrojtje sociale, ekonomi bankare, apo bëhet fjalë për një komunikim të thjeshtë përmes internetit, sot, një pjesë e madhe e të dhënave personale ruhen në format digjital, i cili mundëson një qasje, regjistrim dhe shpërndarje pa pagesë dhe të lehtë. Por, pikërisht për këtë, në mënyrë drastike rritet edhe mundësia që të rrezikohet privatësia. Sot këtë gjë mund ta bëjnë individë, kompani private, por edhe agjenci dhe institucione qeveritare.

Për ta mbrojtur privatësinë e qytetarëve, qeveritë në mbarë botën kanë miratuar ligje dhe politika të shumëllojshme. Për fat të keq, ligjet dhe politikat e propozuara shumë shpesh janë joefikase për shkak të mungesës të një kuptimi të qartë dhe universal të vetë konceptit të privatësisë dhe për shkak të implementimit të tyre edhe më joefikas. Shumë shpesh, në emër të sigurisë të qytetarëve, qeveritë e çrregullojnë baraspeshën mes lirisë dhe privatësisë.

Ky projekt është një tentativë për të dhënë një pasqyrë se si në Maqedoni 35 ligjet nga 12 fusha u përmbahen parimeve të përgjithshme të privatësisë dhe mbrojtjes të të dhënave personale dhe në këtë mënyrë të kontribuojmë për përshtatjen e tyre me parimet dhe standardet e privatësisë në Bashkimin Evropian.

Në Fondacionin „Metamorfozis“, ne mbështesim ligje, politika dhe teknologji korporative të cilat mbrojnë privatësinë e qytetarëve, e njëkohësisht angazhohemi për një kontroll më të madh ligjor dhe mbikëqyrje të institucioneve qeveritare të cilët kanë kompetenca të përgjojnë, për të pamundësuar keqpërdorimin e këtyre kompetencave.

**Bardhyl Jashari**

Drejtor i Metamorfozis  
- Fondacioni për internet  
dhe shoqëri

## REZIME

Hulumtimi i kornizave ligjore dhe institucionale në Republikën e Maqedonisë në lidhje me privatësinë kishte për qëllim të vlerësojë gjendjen dhe mundësitë që këto rregulla ofrojnë për mbrojtjen e privatësisë individuale, por edhe të ofrojë një kornizë referuese dhe metodologji sipas të cilës do të implementoheshin edhe hulumtime të tjera dhe projekte në të ardhmen për përmirësimin e gjendjes me privatësinë.

Me identifikim të ligjeve dhe akteve nënligjore që do të mund të ndikonin në të drejtën e privatësisë të qytetarëve, posaçërisht të atyre ligjeve të cilët kanë të bëjnë me mbledhjen, përpunimin, transferimin dhe ruajtjen e të dhënave personale, dhe pastaj, analizë të tyre juridike sipas disa kriterëve, në mënyrë të lehtë dhe të thjeshtë do të mund t'u bëhet me dije qytetarëve, të cilët shpesh nuk janë ekspertë ligjorë, në cilat mënyra dhe nëpërmjet cilëve institucione do të mund të rrezikohet privatësia e tyre.

Rezultatet e hulumtimit sugjerojnë disa gjëra: së pari, qëndrimet e ekspertëve të fushave të ndryshme shpesh përputhen në raport me nevojën për privatësi dhe mbrojtje të të dhënave personale dhe ngritjen e vetëdijes tek popullata më e gjerë, së dyti, të njëjtët pothuajse njëzëri pajtohen se në Republikën e Maqedonisë, rregullativa ligjore e cila garanton mbrojtjen e të dhënave personale, duke përfshirë këtu edhe masat tekniko-teknologjike të parapara, është në një nivel solid, megjithatë problemin e shohin te implementimi i ligjeve. Analiza juridike e ligjeve, nga ana tjetër, zbulon se një në pjesë të madhe të ligjeve nuk ka afate të caktuara qartë dhe precize për ruajtjen e të dhënave personale, në numrin më të madh të ligjeve të cilët parashohin mbledhje të të dhënave personale nuk parashihet kërkimi i pëlqimit nga subjektet, por edhe që ekzistojnë ligje të cilët pothuajse nuk plotësojnë asnjë kriter për mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave personale.

Sipas mendimeve të ekspertëve, në Republikën e Maqedonisë, gjendja me privatësinë nuk është në nivel të lakmueshëm, por nga ana tjetër ka një tendencë pozitive të përmirësimit. Të njëjtit identifikuan edhe disa mënyra dhe target grupe, me të cilat, sipas tyre, më së shumti mundet dhe duhet të punohet, sepse gjendja me privatësinë dhe mbrojtjen e të dhënave personale paraqet një problem shoqëror, të cilin nuk guxojmë ta injorojmë dhe kemi për detyrë të ngremë vetëdijen publike tek ato grupe të qytetarëve, të cilët nëpërmjet metodave konvencionale të fitimit të njohurive nuk kanë arritur ta njohin rëndësinë e të drejtës së privatësisë dhe nevojën e mbrojtjes të të dhënave personale të tyre, por edhe të privatësisë dhe të të dhënave personale të të tjerëve



## HYRJE

Përparimi gjithnjë e më i shpejtë i teknologjisë në jetën e njerëzve, dhe depërtimi i saj në të gjithë bashkëveprimet e qytetarit të thjeshtë e bën atë një mjet jashtëzakonisht të fuqishëm në zhvillimin e kulturës së shoqërive.

Megjithatë, kur të bie në duar të gabuara, teknologjia dhe prania e saj në jetën e njerëzve paraqet një armë të rrezikshme, e cila është jashtëzakonisht precize, me metoda dhe teknika të përcaktuara saktë, mund të na informojë për të gjithë komunikimin, vendndodhjen gjeografike, historinë financiare etj, të një personi të caktuar ose grupi të interesit.

Kuptohet se mundësitë e këtilla që i ofron teknologjia nuk janë në mënyrë inerte të rrezikshme për cilësinë e jetës së qytetarit të thjeshtë, gjeëgjësisht, shfrytëzimi i zakonshëm i teknologjisë së këtillë u referohet qëllimeve të marketingut, që mund të perceptohen pozitivisht nga përdoruesi përfundimtar – qytetari.

Megjithatë, na imponohet pyetja – kush vendos se deri ku dhe si më saktësisht teknologjia e përdorur për identifikimin e shfrytëzuesve të saj mund të ketë qasje deri te ato informata në çdo kohë? A është i vetëdijshëm qytetari i thjeshtë për transferin e të dhënave të tij personale, siç janë fotografi, histori financiare, vendndodhje gjeografike, i cili kryhet çdo ditë nëpër kanale të ndryshme komunikimi ndërmjet institucioneve private dhe shtetërore dhe korporatave?

Sot, si kurrë më parë, është e nevojshme që shfrytëzuesi i thjeshtë të menaxhojë me praninë e tij virtuale – zhvillimi gjithnjë e më i shpejtë i teknikave të reja për identifikim (me shtypjen e një butoni, me shikim të shkurtër në lentet e kamerës) njëherit sjell edhe rrezik më të madh që ato të dhëna të keqpërdoren. Përgjegjësia personale dhe informimi për çdo shërbim në veçanti është qenësor në hapat për mbrojtjen e privatësisë sonë.

Nga ana tjetër, krahas përgjegjësisë personale për menaxhim të prezencës së tyre virtuale dhe dhënies të të dhënave personale, masa shumë të dobishme për mbrojtje paraqesin edhe normat ligjore në nivel shtetëror dhe global. Domethënë, e drejta e privatësisë dhe e jetës private është një e drejtë e njeriut e njohur në përmasa globale dhe si e tillë i nënshtrohet pranimit të detyrueshëm nga të gjitha shtetet – nënshkruajtës të Deklaratës për të Drejtat e Njeriut.

Aktet ligjore dhe nënligjore mund të bëjnë shumë në drejtim të mbrojtjes së privatësisë dhe të dhënave personale të qytetarëve, nëpërmjet kufizimit, monitorimit, por edhe dënimit të kompanive private, institucioneve të shtetit që i përdorin këto të dhëna në punën e tyre të përditshme. Ashtu siç bëhen më inovative kompanitë në mbledhjen, ruajtjen, dhe transferimin e të dhënave personale – po ashtu, me të njëjtin ritëm, do të duhet të pasojnë edhe normat që do ta mbrojnë qytetarin dhe të drejtën e tij të privatësisë në secilin nga hapat e përpunimit të të dhënave të tij. Detyrim i shteteve është krijimi i një infrastrukture adekuate juridike e cila do ta mbrojë privatësinë e qytetarëve, përfshirë këtu edhe nga vetë organet e pushtetit.

Nevoja për një entitet që do i kontrollojë dhe mbikëqyrë kompanitë e mëdha dhe organet shtetërore gjatë përdorimit të të dhënave personale të qytetarëve nga ana e tyre është shumë e madhe. Një organizatë, organ, apo komision i këtillë do ketë mundësi të propozojë ndryshime të rregulloreve, të paralajmërojë për shkelje të mundshme të privatësisë, të sanksionojë në rast të keqpërdorimit të të dhënave personale, dhe të zbatojë masa dhe teknika përkatëse për ngritjen

e vetëdijes së qytetarëve për rrezikun nga keqpërdorimi i të dhënave të tyre personale.

Në shtetin tonë, organ i tillë është Drejtoria për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (DMDHP).

Ajo është formuar në vitin 2005, me miratimin e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjë që në masë të madhe kontribuoi për përshtatje me rrjedhat evropiane dhe botërore në sferën e të drejtave të njeriut, posaçërisht të drejtës së privatësisë.

Më pas në vitin 2008, miratohet edhe Ligji për ndryshim dhe plotësim të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, me të cilin promovohen hapat pro-evropiane të Republikës së Maqedonisë drejt përshtatjes së bazës ligjore me atë të shteteve anëtare të BE-së. DMDHP është vendi ku qytetarët e R. së Maqedonisë mund të drejtohen nëse kanë dyshim të arsyeshëm se të dhënat e tyre personale keqpërdoren, ruhen më gjatë se ç'është e planifikuar, ndryshohen, janë të pasakta ose u përcillen personave të tretë – gjë për të cilën vetë qytetari nuk ka dhënë leje. DMDHP është e detyruar të iniciojë procedurë hetimore – për këtë qëllim DMDHP ka inspektorë, të cilët janë të përcaktuar me ligj dhe të njëjtët kanë obligim ligjor të hetojnë me anë të masave teknike dhe të tjera, nëse me të vërtetë ka keqpërdorim të të dhënave të tilla, për të cilat nuk ekziston bazë ligjore.

Gjatë viteve të kaluara, pranë DMDHP janë dorëzuar shumë denoncime për keqpërdorim të mundshëm të të dhënave personale nga qytetarët (dokumentin mund ta gjeni në faqen e tyre të internetit), dhe për një pjesë të tyre, gjegjësisht, për ato denoncime ku ka pasur bazë ligjore, procedohet edhe më tej. Megjithatë, nga sasia e denoncimeve, mund të përfundojmë se tek popullata më e gjerë vetëdija për këtë çështje është e ulët. Publiku nuk është i njoftuar me mënyrat e ruajtjes dhe përdorimit të të dhënave personale të tyre, të cilat shumë lehtë ua japin kompanive private. Njëherit, nuk është i njoftuar as me mekanizmat ligjorë të mbrojtjes nga mbledhjet e këtilla të të dhënave personale dhe mundësinë që të drejtohen deri tek palët relevante që do t'u ndihmonin në rast të pasojave negative të shkaktuara nga publikimi i atyre të dhënave.

Prandaj, qëllimi i këtij projekti është edhe ngritja e vetëdijes publike për të drejtat dhe ligjet me të cilët janë të mbrojtura të dhënat e tyre personale – dhe ku të drejtohen në qoftë se dyshojnë se të dhënat e tyre personale janë keqpërdorur.

## KORNIZA LIGJORE PËR PRIVATËSINË

Republika e Maqedonisë ka një kornizë ligjore të vetën e cila e garanton të drejtën e privatësisë dhe mbrojtjes të të dhënave personale. Në nenin 25 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë thuhet:

*„Çdo qytetari i garantohet respektimi dhe mbrojtja e privatësisë së jetës të tij personale dhe familjare, e dinjitetit dhe e autoritetit.“*

Neni 18, thotë:

*„Garantohen siguria dhe fshehtësia e të dhënave personale. Qytetarëve u garantohet mbrojtja nga cenimi i integritetit personal, që buron nga regjistrimi i informatave për ta nëpërmjet të përpunimit të të dhënave.“*

Me kushtetutë është e mbrojtur privatësia dhe liria në komunikim: Neni 17 thotë

*„Garantohet liria dhe fshehtësia e letrave dhe të gjitha formave të tjera të kumtimit. Vetëm në bazë të vendimit gjyqësor, mund të shmanget nga parimi i pacenueshmërisë së fshehtësisë së letrave, nëse ajo është e domosdoshme për mbajtjen e procedurës penale, ose atë e kërkojnë interesat e mbrojtjes së Republikës.“*

Dhe në fund, Neni 26 e garanton paprekshmërinë e shtëpisë:

*„Garantohet paprekshmëria e shtëpisë. E drejta e paprekshmërisë së shtëpisë mund të kufizohet vetëm me vendim gjyqësor kur është në pyetje zbulimi ose pengimi i veprave penale ose mbrojtja e shëndetit të njerëzve.“*

Përveç kornizës ligjore të dhënë në Kushtetutë, në Republikën e Maqedonisë ekzistojnë edhe ligje dhe akte nënligjore plotësuese që e avancojnë mbrojtjen e të dhënave personale të qytetarëve dhe privatësisë së tyre.

Në Ligjin për Mbrojtjen e të dhënave personale, të miratuar më 2005, definohet mënyra në të cilën mbledhen të dhënat personale të qytetarëve, kur lejohet dhe kur nuk lejohet mbledhja dhe ruajtja e tyre, definohen kategoritë e të dhënave personale sipas ndjeshmërisë, njëkohësisht edhe masa për mbrojtjen e të njëjtave nga përpunimi i palejuar.

Në përgjithësi, të dhënat personale të qytetarëve mund të përpunohen vetëm me pajtim absolut, përveç në rastet me rëndësi të madhe për sigurinë e Republikës së Maqedonisë.

Më tej, në ligj janë të shënuara dhe masat teknike të nevojshme për siguri fizike të bazave të të dhënave. Në periudhën pas miratimit fillestar të ligjit në 2005 janë përgatitur më shumë rregullore, të cilat në mënyrë plotësuese i precizojnë masat teknike të nevojshme për institucione të veçanta që bëjnë mbledhjen, ruajtjen dhe/ose përpunimin e të dhënave personale, që edhe më shumë kontribuon për sigurinë e të dhënave.

Në rregulloret më të reja, më e reja e në dispozicion për momentin daton nga 03.2014, janë të paraparë edhe persona-administratorë të bazave të të dhënave, sigurim i masave teknike për siguri fizike dhe mbrojtje nga ndikimet e jashtme të serverëve në të cilët ruhen të dhënat, miratim dhe krijim i qasjes nëpërmjet të fjalëkalimeve deri tek personat që i shfrytëzojnë këto të dhëna në punën e përditshme, më shumë nivele të autorizimit etj.

Në rregulloret dhe aktet nënligjore të fundit vërejmë një prirje të ndjekjes dhe precizimit të normave që i referohen mbrojtjes të të dhënave personale dhe të

drejtës së privatësisë me propozimet e pranuar më gjerë të BE-së dhe skenës globale.

Përveç normave të lartpërmendura kushtetuese dhe ligjore që promovojnë privatësi dhe mbrojtje të të dhënave personale, ekzistojnë edhe një sërë ligjesh dhe aktesh nënligjore të tjerë të cilët u përkasin sektorëve të veçantë (si për shembull, Ligji për statistikë shtetërore dhe Ligji për mbrojtje sociale) të cilët edhe më shumë e sigurojnë këtë të drejtë themelore të njeriut. Meqë organet si policia, agjencioni për punësim, sigurimi pensional etj, i shfrytëzojnë (mbledhin, ruajnë, përpunojnë) të dhënat personale në punën e tyre të përditshme, në ato instanca nevojitet precizim plotësues i mënyrave në të cilat ato të dhëna do të shfrytëzohen, si dhe mekanizmat për mbrojtje nga keqpërdorimi.

Raporti për progresin e Maqedonisë, i publikuar nga Komisioni Evropian më 8 Tetor të vitit 2014, i thekson këto gjendje dhe nevoja:

*„Drejtoria për mbrojtjen e të dhënave personale e zmadhoi numrin e inspektimeve të kryera, prej të cilave 60% u kryen në sektorin privat dhe 40% në sektorin shëndetësor dhe gjyqësi. Pothuajse tek gjysma e këtyre inspektimeve janë vërtetuar shkelje. Numri i ankesave të Drejtorisë ishte stabil, 404 në vitin 2013, prej të cilave 62% janë ankesa lidhur me keqpërdorimin e të dhënave në rrjetet sociale. Në përgjithësi, si rezultat i qasjes proaktive të Drejtorisë numri i shkeljeve të zbuluara dhe të vërtetuara u zmadhua për pothuajse pesë herë, nga 56 në vitin 2012 deri në 254 në vitin 2013. Aktivitetet për ngritjen e vetëdijes së publikut gjithashtu vazhduan, që rezultoi me rritje prej 30% të vizitorëve të faqes së internetit të Drejtorisë. Numri i kontrolluesve dhe nëpunësve për mbrojtjen e të dhënave është rritur dhe trajnimi i tyre është përmirësuar, por gjithashtu katër nga punonjësit u larguan. Drejtoria e dorëzoi raportin e saj të parë tek Eurodrejtësia për mbrojtjen e të dhënave personale në sistemin e prokurorisë publike. Legjislacioni për sektorin në fjalë ende nuk është e përshtatur me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave dhe nevojiten përpjekje shumë më të mëdha që të sigurohet se Drejtoria konsultohet sistematikisht për të gjitha politikat dhe propozim-ligjet e reja. Për shkak të përshtatjes së plotë me acquisë të nevojshme edhe përshtatje plotësuese e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave“.*

## METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Hulumtimi parashihte dy faza të mbledhjes të të dhënave - faza e parë paraqiste implementimin e intervistave të gjysmëstrukturuara më ekspertë, ndërsa faza e dytë përbëhej nga analiza juridike e ligjeve të identifikuar që kanë potencial ta dëmtojnë të drejtën e privatësisë së qytetarëve.

Në fazën e parë, pjesëmarrësit në intervista u zgjodhën sipas disa kriterëve – arsimimi i tyre formal, përvoja e punës së tyre në problematikë e cila i përket fushës së privatësisë dhe mbrojtjes të të dhënave personale, si dhe ekspozimi i përditshëm ndaj një numri të madh të të dhënave personale të qytetarëve. Edhe pse në fillim u dërguan ftesa speciale drejt një numri të madh të institucioneve shtetërore (ministrive) për nominim të përfaqësuesit i cili do të merrte pjesë, hasëm në një reagim të dobët për bashkëpunim – vetëm një nga gjithsej tetë institucione shtetërore pranoi të marrë pjesë në hulumtim, me nominim të përfaqësuesit të vet i cili i plotësonte kriteret e lartpërmendura.

Intervistat e gjysmëstrukturuara, si metodë cilësore, u zgjodhën për disa arsye: ato lejojnë një kuptim më të thellë të qëndrimeve dhe mendimeve të ekspertëve, dhe kundrejt metodave të tjera, për shembull grupi i fokusit ose intervistë e standardizuar, intervistat e gjysmëstrukturuara japin një dozë të caktuar të lirisë në diskutim në raport me rrjedhën e bisedës dhe pyetjeve të parashtruara, por më me rëndësi në raport me „lirinë” e shprehjes tek pjesëmarrësit.

Për shkak se tema e hulumtimit është e një natyre të ndjeshme, përdorimi i grupeve të fokusit ose intervistave grupore do të pengonte që qëndrime të caktuara të pjesëmarrësve „të dalin në sipërfaqe” për shkak të prezencës së personave të tjerë në proces.

Kuptohet se gjeneralizimi i zbulimeve nga intervistat e gjysmëstrukturuara është i panevojshëm, sepse ato japin një pasqyrë vetëm për qëndrimet dhe mendimet e pjesëmarrësit, edhe pse në formulim të disa deklarimeve të pjesëmarrësve përdoren edhe përshkrime për popullatën më të gjerë.

Për më tepër, pjesëmarrësit në intervista mbushnin edhe një fletë anketuese, e cila kontribuoi për një shqyrtim plotësues, më objektiv të mendimeve dhe qëndrimeve të tyre, dhe njëherit lejoi një krahasueshmëri më të madhe ndërmjet qëndrimeve të vetë pjesëmarrësve në intervistat në fusha të ndryshme.

U kryen me sukses 8 intervista, me kohëzgjatje mesatare prej 25 minutash. Për shkak se pjesëmarrësit diskutonin dhe ndanin qëndrime për një temë mjaft të ndjeshme, identiteti i tyre u garantua se do të jetë i njohur vetëm për hulumtuesin, me qëllim që të mos kenë pasoja në jetën profesionale dhe private.

# REZULTATET E ANALIZËS SË QËNDRIMEVE DHE MENDIMEVE TË EKSPERTËVE

## Karakteristika të ekspertëve të intervistuar, sipas sektorëve

- 2 nga sektori arsimor
- 1 nga sektori civil
- 1 ekspert për media
- 1 specialist për marrëdhënie pune
- 1 udhëheqës në ndërmarrje publike
- 1 nga sektori i telekomunikimit
- 1 nga sektori i sigurimeve

★ Sa është me rëndësi ruajtja, përpunimi dhe transferimi i të dhënave personale të qytetarëve për punën e përditshme të institucionit/organizatës të cilës i përkisni?

Pas pyetjes së parë, të gjithë ekspertët e intervistuar e ndanin qëndrimin se të **dhënat personale** të qytetarëve kanë një **rëndësi qenësore** për funksionimin e përditshëm të institucioneve, gjegjësisht, se pa përpunim dhe ruajtje të të dhënave **personale** – kompanitë dhe institucionet nuk do të mund të funksiononin.

★ Sa është i njoftuar institucioni/organizata e juaj me rregullat ligjore dhe rregulloret për mbrojtjen e të dhënave personale?

Për këtë pyetje thuajse të gjithë ekspertët u shprehën se institucionet e tyre janë **të njoftuar mirë** me rregullat ligjore dhe rregulloret. Një pjesë e ekspertëve e vlerësuan pozitivisht punën e DMDHP-së në raport me trajnimet e rregullta dhe rekomandimet që vijnë nga ana e tyre, e që u ndihmojnë në edukimin e punonjësve të tyre për rëndësinë e mbrojtjes së të **dhënave personale** dhe të drejtën e privatësisë. Gjithashtu, pothuajse të gjithë ekspertët ishin të një mendimi se **ekziston hapësirë për përmirësim** në këtë fushë, **veçanërisht** tek punonjësit, ose sektorët, të cilët: 1. **Komunikojnë drejtpërdrejt** me klientët/palët (dhe kanë qasje tek të dhënat e tyre personale) dhe 2. **Nuk janë** pjesë e sektorit juridik ose IT në institucionin/kompaninë e tyre (për këto dy sektorë ekspertët konsideronin se janë të njoftuar plotësisht me rregullat ligjore dhe rregulloret).

★ Sipas jush, a ekziston rreziku i zbulimit të përmbajtjeve në punën e përditshme të institucionit/organizatës të cilat do ta dëmtonin privatësinë e qytetarëve? Nëse ekziston, çfarë mendoni se do të mund të bëhej që të eliminohet ose zvogëlohet ky rrezik?

Për këtë pyetje, ekspertët ishin unanimit: rreziqet ekzistojnë gjithmonë, mirëpo ato janë të vegjël dhe të parëndësishëm, dhe vazhdimisht punohet në sanimin e tyre. Kjo arrihet nëpërmjet edukimit të vazhdueshëm të punonjësve, nëpërmjet vendosjes së standardeve të larta për siguri teknike të serverëve dhe bazave të të dhënave ku mbahen të dhënat personale, si dhe ndjekjes së zhvillimit të teknologjisë dhe plotësimit të rregulloreve për punë.

Ekspertët i ndanë rreziqet në **dy fusha** – rreziqe teknike dhe rreziqe që burojnë nga vetë punonjësit. Rreziqeve teknike u japin rol të parëndësishëm, gjegjësisht, janë të kënaqur me përdorimin e mjeteve më të sofistikuar dhe protokolleve të sigurisë për të cilat janë përgjegjës sektorët IT të tyre, ndërsa **më shumë hapësirë për përmirësim** konsiderojnë se ka në pjesën e edukimit të punonjësve, veçanërisht

**të punonjësve të rinj.** Raporti personal i punonjësve (dhe qytetarëve) ndaj të drejtës së privatësisë dhe rëndësia e mbrojtjes të të dhënave personale të të tjerëve është në një nivel shumë të ulët. Me fjalë të tjera, vetëdija tek qytetarët për këtë problematikë është **shumë e ulët** dhe e papërfaqësuar në rrethet e gjera, dhe nga kjo rrjedh rreziku më i madh për shkeljen e të drejtës së privatësisë.

**\* Si do ta vlerësonit klimën e përgjithshme në institucionin/organizatën tuaj në lidhje me nevojën për privatësi dhe mbrojtje të të dhënave personale?**

Ekspertët për këtë pyetje ishin unanimit në qëndrimin se në të gjithë institucionet dhe kompanitë bëhet kujdes për të dhënat personale të qytetarëve dhe mbrojtjen e privatësisë të tyre. Një pjesë e tyre deklaruan se, megjithatë, në institucione të caktuara shtetërore kjo praktikë nuk trajtohet aq sa duhet, veçanërisht në institucione të lidhura me **shëndetin publik**, dhe **nuk ka shumë kujdes** për privatësinë e tjetrit, mirëpo, në përgjithësi, ekziston një **klimë** e caktuar ndërmjet punonjësve në të gjithë sektorët se **të dhënat personale janë të rëndësishme** dhe se e drejta e privatësisë e qytetarëve **duhet** të respektohet.

**\* Si do ta vlerësonit vetëdijen e publikut të gjerë në drejtim të të drejtës së privatësisë?**

- \* **Sa është e rëndësishme nevoja për ngritjen e vetëdijes tek popullata e gjerë për të drejtën e tyre themelore të privatësisë?**
- \* **Ku mendoni se ekziston hapësirë më e madhe për përmirësim?**

Pothuajse të gjithë ekspertët e intervistuar për këtë pyetje ishin të një mendimi se vetëdija tek publiku më i gjerë është **në nivel shumë të ulët**. Qytetari i thjeshtë është shumë pak i njoftuar me të drejtat e tij sa i përket të drejtës së privatësisë dhe përdorimit të të dhënave të tij personale, si dhe dëmet dhe pasojat e mundshme të të njëjtës. Disa nga ekspertët shprehën edhe mendim se qytetarët janë të njoftuar me të drejtat e tyre, mirëpo, **thjesht, nuk u japin rëndësi** dhe në mënyrë të vetëdijshme **lejojnë** që privatësia e tyre të shkelet.

**Të gjithë** ekspertët u pajtuan se është **shumë e rëndësishme** nevoja për ngritjen e vetëdijes së popullatës më të gjerë për këto koncepte themelore dhe disa prej tyre konsideronin se me **edukim** të vazhdueshëm, sidomos në moshën e hershme, shkollë, dhe me edukim familjar, do të mund të arrihet që gjeneratat e ardhshme të jenë të informuar dhe të kujdesshëm në vendimet e tyre kur të vijnë në situata ku e drejta e **privatësisë** do të jetë potencialisht e rrezikuar. Një pjesëmarrës në intervistë tregoi një shembull ku mund të veprohet sistematikisht dhe me plan tek kuadrot tashmë të punësuar (qoftë shtetërore ose në kompani private) – nëpërmjet një edukimi të **sistematizuar** dhe të planifikuar të vazhdueshëm në **vendet e punës**, për të cilin financiarisht do të jetë përgjegjëse vetë kompania/

*Gjithmonë ekziston rrezik, dhe unë gjithmonë them se më e rëndësishme nga të gjitha është ndërgjegjshmëria e vetë punonjësve. Ato të dhëna me të vërtetë paraqesin një pasuri të njerëzve dhe pikërisht për këtë duhet të ruhen. Në atë drejtim shkojnë edhe trajnimet – se nuk janë të rëndësishme vetëm masat teknike që i ndërmerr kompania, të cilat janë vërtetë në një nivel shumë të lartë, por edhe masat organizative janë shumë të rëndësishme.”*

**„...nëse lejohet ▯ ▯  
mbledhje masovike e  
të dhënave personale,  
pa autorizim,  
kemi problem, të  
përbashkët. Nuk  
kemi kontroll mbi  
ato të dhëna dhe  
ku të njëjtat mund  
të përcillen, qoftë  
edhe jashtë kufijve  
të Republikës së  
Maqedonisë. Në këtë  
drejtim ka hapësirë  
të mjaftueshme për  
përmirësim...” ▯ ▯**

institucioni, efekti i të cilit nuk do të mbetet vetëm në mjedisin e punës, por do të **„derdhet”** edhe në mjedisin shtëpiak, familjen, sepse „...Ashtu si do të sillen në punë, atë kulturë do ta përcjellin edhe në shtëpi.” Pastaj, i vogël është hapi nga kultura shtëpiake e deri tek kultura dhe **atmosfera shoqërore**.

Pas nënpikës së fundit, pothuajse të gjithë ekspertët ishin unanimit se hapësirë **më e madhe** për përmirësim ekziston tek **popullata e re**, adoleshentët dhe nxënësit në shkollat fillore dhe të mesme. Me zhvillimin e shpejtë të teknologjisë dhe pajisjeve celulare, aplikacioneve të shumta për to, si dhe rrjeteve sociale, të rinjtë vazhdimisht janë të ekspozuar ndaj rrezikut që të dhënat e tyre personale të ekspozohen, përdoren, përcillen dhe ruhen, në vende dhe mënyra për të cilat ato nuk janë mjaft të informuar (edhe pse, ndoshta, paraprakisht kanë dhënë pëlqim). Me pajtimin me kushtet e përdorimit të aplikacioneve dhe rrjeteve sociale ekspertët mendojnë se ato nuk janë mjaft të informuar deri në çfarë shkallë vendosin të „tregtojnë” me privatësinë e tyre dhe të dhënat personale.

#### **★ A keni qenë Ju personalisht në situata ku ju jetë shkelur e drejta e privatësisë? Nëse po, si keni vepruar?**

Për këtë pyetje ekspertët e intervistuar ishin të **ndarë** – pothuajse gjysma e tyre deklaruan se **asnjëherë** nuk janë ndjerë se u është shkelur **e drejta e privatësisë**, ndërsa **gjysma tjetër** pohuan se **pothuajse çdo ditë** u shkelet e drejta e privatësisë. Megjithatë, grupi që u përgjigj me pohim, **rastet** e cenimit të privatësisë së tyre **ia ngarkuan** pakujdesisë së punonjësve në institucione/kompani të caktuara, gjegjësisht, se më shumë i **rastësishëm** se sa dëmtim i qëllimshëm i privatësisë. Për këtë arsye, asnjëri nga ekspertët që deklaruan se u është shkelur e drejta e privatësisë, **nuk kanë vendosur** që të ngrenë procedurë për ato situata. Përveç gabimeve të rastësishme dhe situatave të pakëndshme, disa ekspertë deklaruan se kanë qenë viktima të **„spam”**-it nga kompani të caktuara private, nëpërmjet SMS-mesazheve, **postës elektronike**, telefonatave etj, edhe pse për këtë **nuk kanë dhënë pëlqim**. Për këto veprime kanë **reaguar** në mënyrë adekuate dhe komunikimi i mëtejshëm është ndërprerë.

#### **★ Për cilat institucione/agjencione/organizata keni njohuri që disponojnë, i shfrytëzojnë dhe i përpunojnë të dhënat Tuaja personale?**

Pyetjen e mësipërme e përdorëm që të japim një pasqyrë se sa janë të vetëdijshëm vetë ekspertët, të cilët për çdo ditë merren me këtë problematikë, për përdorimin dhe ruajtjen e të dhënave të tyre personale, krahasuar me publikun e gjerë. Në atë kuptim, ekspertët, me përjashtim të njërit pjesëmarrës, e **vërtetuan** supozimin tonë se ato do të kishin më shumë njohuri se cilat institucione/kompani disponojnë me të dhënat e tyre personale. Me përjashtim të njërit pjesëmarrës në intervistat, i cili arriti në numërojë vetëm tre institucione për të cilat kishte njohuri se disponojnë dhe i përdorin të dhënat e tij personale, ekspertët e tjerë **numëronin** më shumë se 10 kompani private dhe institucione, të cilët për momentin disponojnë dhe i përdorin të dhënat e tyre personale.



### \* Si e vlerësoni rolin e teknologjive të reja në lidhje me të drejtën e privatësisë së qytetarëve?

Ekspertët ishin të një mendimi për disa **pika** të kësaj pyetje.

Ndanin qëndrimin se teknologjitë e reja kanë një **potencial të madh** për shkelje të privatësisë së shfrytëzuesve të tyre:

Teknologjitë shumë **më shpejtë** depërtojnë në përditshmërinë e qytetarit sesa ai/ ajo është i/e gatshëm/e të **mësojë** për aq kohë të shkurtër për **rreziqet** lidhur me përdorimin e tyre;

Prandaj, nevoja për edukim dhe **informim** të vazhdueshëm kur marrin **vendime** në raport me teknikën dhe teknologjinë që e përdorin çdo ditë bëhet një çështje posaçërisht e rëndësishme, dhe

Teknologjia është vetëm **mjet**, i cili mund të shërbejë edhe për mbrojtje të privatësisë dhe të dhënave personale të dikujt, aq sa mund të shërbejë edhe për të shkelur të njëjtat – **qëllimet e personit** që e përdor teknologjinë mbeten një ndër faktorët **më të rëndësishëm** në përcaktimin e asaj nëse teknologjitë e reja janë pozitive apo negative në raport me privatësinë e qytetarëve.

### \* Si e vlerësoni rolin e internetit, më saktësisht rrjeteve sociale, në lidhje me të drejtën e privatësisë?

Ekspertët ishin unanimit në qëndrimin se rrjetet sociale dhe interneti kanë një rol të pazëvendësueshëm në shoqërinë dhe funksionimin shoqëror sot. Të njëjtët i kënaqin orekset e shumë qytetarëve për socializim dhe zgjerim të kontakteve dhe pasurim me informacione.

Megjithatë, ekspertët gjithashtu deklaruan se numri më i madh i rasteve nga jeta private, kontakte me miq dhe të njohur, ku ka ekzistuar shkelje e ndonjë të drejtë të privatësisë dhe/ose keqpërdorim i të dhënave personale – burojnë pikërisht nga rrjetet sociale. Kështu që, pajtohen se përdorimi i rrjeteve sociale është thike me dy tehe – ekziston rrezik i madh për shkelje të të drejtës së privatësisë, mirëpo, ato gjithashtu sjellin edhe benefite të mëdha. Si arsye për këtë shkelje të së drejtës së privatësisë në rrjetet sociale ekspertët theksojnë:

Informimin e dobët të përdoruesve për **kushtet e pranuar të përdorimit** të përmbajtjeve të tyre;

Udhëzimet **shumë të komplikuar** për rregullimin e „nivelet të privatësisë” të të dhënave që i shpërndajnë përdoruesit, si dhe

**Informimin e pamjaftueshëm** për rreziqet potenciale dhe pasojat e mundshme nga përdorimi i pakujdesshëm i rrjeteve sociale dhe përmbajtjeve të tyre.

Për nënpikën e fundit, njëri nga ekspertët shfaqti një shqetësim të veçantë për informimin e pamjaftueshëm tek popullata e re, përkatësisht tek nxënësit në shkolla të mesme dhe fillore. Për shkak se një numër i madh i këtyre nxënësve çdo ditë në mënyrë aktive i përdorin rrjetet sociale dhe internetin, rreziqet për shkeljen e privatësisë së tyre dhe të tjerëve janë të mëdha.

„Rrjetet sociale janë të nevojshme, ato janë mjete të fuqishme për aktivitet social, kënaqje të orekseve të njerëzve për socializim... megjithatë janë thikë me dy tehe, sepse lehtë mund të vijë deri tek shkelja e privatësisë.”

★ Ku mendoni se duhet të ekzistojnë përjashtime nga kjo e drejtë themelore, gjegjësisht kur është më mirë të lejohet shkelja i privatësisë dhe përdorimi i të dhënave personale pa leje të veçantë? Cilat institucione do ta kishin këtë të drejtë?

Ekspertët u pajtuan se duhet të ekzistojnë përjashtime, gjegjësisht të mund të shkelet privatësia e qytetarëve ose grupeve të qytetarëve, mirëpo:

Secili nga ato përjashtime duhet të jetë i paraparë më ligj;

Vetëm disa institucione ta kenë atë të drejtë, më saktësisht, vetëm sektorë të caktuar në ato institucione;

Për secilin rast të shkeljes të privatësisë së dikujt të gjykohet në veçanti, gjegjësisht, të vlerësohet a është me të vërtetë e nevojshme, dhe

Parakushti më i rëndësishëm kur qoftë edhe do të mendohet për monitorim të aktiviteteve, telefonatave, llogarive bankare etj, të dikujt, është kur ka **indikacione serioze** se personi ose grupi është i përfshirë në veprime të cilat janë **kundër sigurisë shtetërore**. Nëse veçse ekziston

kallëzim penal dhe veprime kriminale të vërtetuara, gjithashtu nuk respektohet e drejta e privatësisë së fajtorit, gjegjësisht **përkohësisht pezullohet**, në mënyrë që të mundën organet gjyqësore dhe prokurori publik t'i kryejnë **detyrimet e tyre ligjore**. Ekspertët gjithashtu ranë dakord se institucionet si MPB, Gjykatat, Prokurori Publik, DAP dhe Qendrat e Urgjencës, duhet ta kenë këtë të drejtë.

★ Si e vlerësoni situatën me privatësinë dhe mbrojtjen e të dhënave personale në Republikën e Maqedonisë? Si e vlerësoni situatën në botë? (tendencat)

Pjesa më e madhe e ekspertëve deklaruan se gjendja me privatësinë dhe mbrojtjen e të dhënave personale ka një **tendencë pozitive** edhe në shtetin tonë edhe në botë. Ata mendojnë se nuk mund të krahasohemi me ndonjë nga vendet më të zhvilluara të Evropës perëndimore, mirëpo se edhe në shtetin tonë bëhen përpjekje dhe **dalëngadalë ngrihet vetëdija** tek publiku më i gjerë sa i përket kësaj problematike.

Në atë kontekst, punën e DMDHP-së e vlerësuan si një tendencë shumë pozitive që tashmë ka filluar të japë rezultate. Të gjithë ekspertët, **përfshirë** edhe ato që nuk pajtoheshin se ekzistojnë tendenca pozitive tek ne dhe në botë, mendojnë se në **shoqëritë e zhvilluara demokratike** ekzistojnë shumë kuptime të ndryshme për atë se ç'është privatësia dhe për nevojën e të drejtës së privatësisë (përfshirë edhe mbrojtjen e saj) – dhe të njëjtat i ndajnë në **dy** blloqe „kryesore” - **Vendet Europëroëndimore**, ku e drejta e privatësisë është shumë e rëndësishme dhe ndërmerren **përpjekje të mëdha për mbrojtje të privatësisë** dhe mbrojtjen e të dhënave personale, dhe **SHBA-të dhe Kanadaja**, ku, virtualisht as që ekziston e drejta e privatësisë, gjegjësisht, ku çdo ditë shkelet kjo e drejtë, dhe **shkëmbehen, ruhen dhe përpunohen** sasi të mëdha të të dhënave personale pa pëlqimin e qytetarëve dhe përdoruesve.

„Mendoj se vetëdija për privatësinë ende nuk ekziston, duke u nisur nga ajo se tek masat e gjëra popullore nuk është e definuar se çfarë do të thotë privatësi.”

Ekspertët e vendosin shtetin tonë - „diku në **mes**”, gjegjësisht, që ekziston një hapësirë **e madhe** për përmirësim, veçanërisht tek vetëdija e popullatës më të gjerë për këtë çështje, por që edhe tek ne ekzistojnë shembuj **mjaft pozitivë**, siç është miratimi i Ligjit për mbrojtje të të dhënave personale, formimi i Drejtorisë për Mbrojtje të të Dhënave Personale, revizionet e vazhdueshme të **rregulloreve të brendshme për punë** në shumicën e institucioneve shtetërore që të ketë pajtueshmëri me masat e propozuara nga DMDHP-ja etj.

Pastaj, qëndrimet dhe mendimet e ekspertëve u shënuan edhe para vetë intervistave me shfrytëzimin e një ankete të thjeshtë. Në faqet në vazhdim janë shfaqur vizualisht përgjigjet e ekspertëve.

Fletën anketuese të cilën e mbushën të gjithë pjesëmarrësit para intervistave mund ta shikoni të bashkangjitur në fund të këtij botimi.

*„...nga njëra anë, nuk kemi kurrfarë kontrolli efektiv të organeve shtetërore, të përpunimit të të dhënave personale nga ato. Nga ana tjetër, një nga mënyrat që të përmirësohet kjo gjendje është me të ashtuquajturën whistleblowing. Depërtimet më të mira, ose rastet kur janë zbuluar keqpërdorime të të dhënave personale, nuk kanë ndodhur gjatë një inspektimi nga inspektorë që kanë ardhur kanë kapur dikë, por janë bërë nga njerëzit brenda këtyre institucioneve/kompanive. Individë, të cilët i ka detyruar ndërgjegjja ...”*

## Rezultatet e anketimit të ekspertëve:

Pjesëmarrës në anketë ishin ekspertë me nga një përfaqësues nga çdo sektor, përveç sektorit të arsimit, nga ku kishim dy pjesëmarrës. Pjesëmarrësit e tjerë u përkisnin sektorëve: Organizata Joqeveritare, Medie, Marrëdhënie Pune, Ndërmarrje Publike, Telekomunikim dhe Sigurim.

Sa i përket pyetjes së parë, ekspertët bënë një ndarje sipas ligjeve në bazë të të cilëve veprojnë sektorët e caktuar. Gjysma e tyre nuk kishin përgjigje në pyetjen – Në bazë të cilit ligj parashihet grumbullimi i të dhënave personale në sektorin tuaj? Nga ligjet e parashtruar të cilët mundën t'i identifikojnë ishin Ligji për arsimin fillor, të mesëm dhe të lartë, si dhe Ligji për supervizion të sigurimit.

Me përjashtim të dy nga të anketuarit, të tjerët kishin njohuri se – cilat janë format e ruajtjes së të dhënave personale që janë të parapara nëpër sektorë.

Me përjashtim të një të anketuarit, i cili u deklarua se qëllimi i mbledhjes të të dhënave personale nuk mund të kuptohet qartë nga vetë teksti i ligjit, të tjerët u përgjigjën me pohim, gjegjësisht se qëllimi i mbledhjes të të dhënave mundet të kuptohet qartë në tekstin e vetë ligjeve.


Qëndrimi i ekspertëve për justifikueshmërinë e vëllimit të të dhënave personale që mbledhen ishte se ai është i përshtatshëm, gjegjësisht 6 nga 8 të anketuar u deklaruan me pohim – vëllimi i përshtatet qëllimit.

Me përjashtim të njërit nga të anketuarit, i cili u deklarua se institucione të tjera shtetërore janë të obliguar për mbledhjen e të dhënave në sektorin e tij, sektorët e tjerë kanë kapacitete dhe detyrime të parapara me ligj që t'i mbledhin të dhënat personale.

Gjysma e ekspertëve deklaruan se i dorëzojnë për shfrytëzim të dhënat personale, në pajtim me ligjin, ndërsa gjysma tjetër u deklaruan se të dhënat personale nuk u jepen në shfrytëzim personave të tretë.

Numri më i madh i sektorëve (5 nga gjithsej 8) parashohin kërkimin e pëlqimit nga subjekti për përpunim të të dhënave të tij personale, mirëpo vetëm për kategori të caktuara të të dhënave personale.

**Grafiku 1: Pëlqim për përpunim**



Si qëllim më të shpeshtë për të cilin kërkohet pëlqim, dhe kategori më e shpeshtë, të anketuarit i numëruan: numrin e amzës, emrin dhe mbiemrin, datën e lindjes, numrin e telefonit, shënimet mjekësore, adresën, llogarinë bankare, ndërsa si arsye më të shpeshtë për kërkim të pëlqimit numëruan – qëllimet e marketingut.

Gjysma e të anketuarve deklaruan se në ligjet përkatëse nuk ekzistojnë afate të qarta dhe konkrete për ruajtjen e të dhënave personale, gjegjësisht, në vetë tekstin e ligjit nuk ka përcaktim të qartë, përderisa gjysma tjetër e deklaronte të kundërtën.

Në pyetjen – Sa është periudha e paraparë për ruajtjen e të dhënave personale? – përgjigje morëm vetëm nga tre persona nga të anketuarit, edhe atë: duke filluar nga 1 vjet, pastaj 5 vjet, dhe 10 vjet dhe afat i papërcaktuar (libra me vlerë afatgjatë), varësisht nga të dhënat.

Në pyetjen – A ekziston nen i veçantë për mbrojtjen e të dhënave personale i cili flet qartë për aplikimin e masave teknike dhe organizative? – të anketuarit përsëri ishin të ndarë, 50% prej tyre kanë miratuar masa teknike dhe organizative, por në gjysmën e sektorëve nuk janë të inkuadruara masat e reja teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në pyetjen – A keni miratuar Ju akte të brendshme për masa teknike dhe organizative për fshehtësi dhe mbrojtje të të dhënave personale?, me përjashtim të njërit nga sektorët, të gjithë të tjerët kanë miratuar akte plotësuese të brendshme, shpesh në bashkëpunim me DMDHP-në.

„A është i paraparë me këtë ligj përpunimi i të dhënave, apo duhet të jetë i lidhur dhe i aplikuar me ligj tjetër?” – Dy nga të anketuarit deklaruan se përpunimi i të dhënave personale nuk është i paraparë me ligjin e tyre dhe prandaj aplikohet sipas një ligji tjetër, ndërsa për gjashtë të tjerët, në vetë ligjin është i përcaktuar qartë përpunimi i të dhënave personale.

Në pyetjen – A ekzistojnë përjashtime për përpunim të të dhënave të ndjeshme personale (numër amze, biometri, video mbikëqyrje), gjysma e të anketuarve deklaruan se ekzistojnë përjashtime të tilla, përderisa tre deklaruan se nuk aplikohen procedura të tilla në sektorët e tyre, gjegjësisht, nuk ekzistojnë kategori të të dhënave personale që nuk përpunohen.

**Grafiku 2: Përjashtime gjatë përpunimit**



Nga sektorët që bëjnë përjashtim dhe i kategorizojnë të dhënat personale sipas ndjeshmërisë, vetëm një numër i vogël janë të njoftuar me përjashtimet e definuara, gjegjësisht 3 nga gjithsej 8 i treguan kategoritë vijuese të të dhënave personale që nuk përpunohen: numri i amzës, shënimet mjekësore, video mbikëqyrja dhe njëri nga sektorët deklaroi se posedojnë bazë dhe regjistër të veçantë për të dhëna të ndjeshme, të veçuar nga baza e rregullt.

Gjysma e sektorëve nuk kishin informacion për disponueshmërinë e mendimeve të DMDHP-së, përderisa dy nga të anketuarit nuk kanë informacion se DMDHP nuk ka dhënë mendim mbi ato ligje, dhe më tej, vetëm dy nga të anketuarit kishin informacion se mendimi i DMDHP-së është marrë parasysh për ligjet e tyre.

## MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

Mbrojtja e të dhënave personale është një koncept ligjor relativisht i ri në Republikën e Maqedonisë, edhe pse ajo është e garantuar me Kushtetutën e vitit 1991. E drejta për mbrojtjen e të dhënave personale është një nga të drejtat themelore të njeriut, por vazhdon të mbetet e diskutueshme se sa dimë ne për këtë të drejtë tonën dhe nëse dimë të dallojmë se kur na cenohet e drejta e privatësisë?

Ideja që kanë njerëzit për atë se çfarë në të vërtetë është privatësia dallon, por e përbashkët është se ne të gjithë jemi të vetëdijshëm për nevojën për mbrojtje të privatësisë tonë.

Mbrojtja e të dhënave personale depërton në të gjithë segmentet e veprimit shoqëror dhe kjo tregon për faktin se për çfarë materie komplekse bëhet fjalë. Vëllimi i madh i të dhënave të cilat i prezantojmë për çdo ditë në vende të ndryshme dhe për arsye të ndryshme, imponon dhe pyetje të shumta për atë se çfarë në fakt ndodh me të dhënat tona personale.

Ku duhet ta japim numrin tonë të amzës dhe për çfarë qëllimi e bëjmë këtë? A duhet të ruajë punëdhënësi një kopje të letërnjoftimit tonë dhe, a duhet të jemi të mbikëqyrur në vendin tonë të punës? Si duhet t'i ruajë nga keqpërdorimi të dhënat tona mjekësore një institucion shëndetësor? A është në rregull që ta shohim emrin tonë në listën e banorëve të cilët nuk kanë shlyer pagesën për mirëmbajtjen e pallatit? Në çfarë intervale kohore duhet të plotësojmë formularë me të dhënat tona për nevojat e bankave? A duhet të japim një kopje të letërnjoftimit tonë kur duam të këmbejmë 10 euro? Çfarë regjistrojnë kamerat e vendosura në udhëkryqe dhe kush i posedon ato regjistrime dhe fotografi?

Këto janë vetëm një pjesë e pyetjeve të cilat i parashtrojmë gjithnjë e më shpesh, por cilat janë përgjigjet?

Sipas Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, të dhënat tona duhet të përpunohen drejtë dhe në përputhje me ligjin, dhe të jetë të përshtatshme, relevante dhe jo tepër të vëllimshme krahasuar me qëllimin për të cilin mbledhen dhe përpunohen. Të drejtat të cilat garantoohen me këtë ligj janë: e drejta për informim se për ç'qëllim një institucion, apo kompani e caktuar bën mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave tona personale, e drejta për qasje në të dhënat tona personale të cilat institucioni ose kompania i përpunon, e drejta për të kërkuar korrigjim ose fshirje të të dhënave të cilat janë të gabuara, tepër të vëllimshme ose të dhënave të cilave u ka kaluar afati i caktuar kohor për ruajtje, e drejta për të dhënë pëlqim ose për të refuzuar të na bëhet një marketing i drejtpërdrejtë.

Natyrisht që secili nga ne ka të drejtë t'i drejtohet secilit institucion ose kompani dhe të informohemi për atë se në çfarë mënyre e garantojnë fshehtësinë dhe mbrojtjen e të dhënave tona personale.

# ANALIZË JURIDIKE E LIGJEVE

## Metodologjia e analizës juridike

Për nevojat e përgatitjes së analizës juridike për pajtueshmëri të ligjeve të veçanta me Ligjin për mbrojtje të të dhënave personale u definuan katër faza:

1. Definimi i fushave të aplikimit të Ligjit për mbrojtje të të dhënave personale
2. Definimi i ligjeve që aplikohen në fushat e definuara.
3. Përcaktimi i metodologjisë të hulumtimit.
4. Analiza e përgjigjeve të pyetjeve të përcaktuara me metodologjinë. ;

### Definimi i fushave të aplikimit të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Definimi i fushave ku aplikimi i Ligjit për mbrojtje të të dhënave personale ka një rëndësi të veçantë për qytetarët u bë në bazë të analizës së pyetjeve më të shpeshta që qytetarët i kanë parashtruar tek DMDHP- ja në periudhën Qershor 2011 – Shtator 2014. Në analizë në mënyrë plotësuese u përfshinë edhe përgjigjet që qytetarët i kanë marrë nga ana e DMDHP që paraqesin një tregues të llojit të veçantë të gjendjeve për secilën fushë në veçanti.

Pas analizës së kryer të pyetjeve të qytetarëve dhe përgjigjeve të DMDHP-së, u definuan 12 fusha për analizë edhe atë: sigurimi, telekomunikimi, gjyqësia dhe siguria, bankat, shëndetësia, mediet, marrëdhëniet e punës, arsimit, banimit, çështjet sociale, veprimi i ndërmarrjeve publike.

### Definimi i ligjeve që aplikohen në fushat e definuara

Pas definimit të fushave ku aplikimi i Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale ka rëndësi të veçantë për qytetarët, u bë një zbulim i ligjeve që aplikohen në secilën prej fushave të lartpërmendura. U zbuluan gjithsej 35 ligje e pastaj u krijua baza e teksteve të gjithë ligjeve.

### Përcaktimi i metodologjisë së hulumtimit

Në përcaktimin fillestar të metodologjisë për kryerjen e analizës juridike nevojitej definim i pyetjeve të cilave duhet t'u përgjigjet analiza juridike.

Si bazë për definim të pyetjeve për analizë u morën parimet për mbrojtjen e të dhënave personale në pajtim me të cilat të dhënat personale përpunohen drejtë dhe në pajtim me ligjin, mblidhen për qëllime konkrete, adekuate dhe të përcaktuara me ligj dhe përpunohen në mënyrë që është në pajtim me ato qëllime, adekuate, relevante dhe jo tepër e vëllimshme në raport me qëllimet për të cilat mblidhen dhe përpunohen, të sakta, të plota dhe të azhurnuara sipas nevojës, jo më gjatë seç është e nevojshme të plotësohen qëllimet për të cilat janë mblidhur të dhënat.



U definuan 11 pyetje në bazë të së cilave u krye analiza e 35 ligjeve në 12 fushat.

1. A parashih ligji mbledhje të të dhënave personale dhe në cilën formë? (evidencë, regjistër, bazë)
2. Për cilin qëllim është e paraparë mbledhja e të dhënave personale dhe a është qëllimi i qartë?
3. A i përshtatet qëllimit vëllimi i të dhënave që përpunohen?
4. Kush fillimisht i mbledh të dhënat? (kompania, institucioni)
5. A është paraparë pëlqimi i subjektit për përpunimin e ndonjë kategorie të të dhënave personale?
6. A janë paraparë afate konkrete dhe të qarta për ruajtjen e të dhënave personale?
7. A ekziston një nen i veçantë për mbrojtjen e të dhënave personale i cili tregon qartë përdorimin e masave teknike dhe organizative?
8. Përpunimi i të dhënave i paraparë më këtë ligj, a është ose a duhet të jetë i lidhur edhe me aplikim të ndonjë ligji tjetër?
9. A ekzistojnë përjashtime për përpunim të të dhënave personale të ndjeshme? (numri i amzës, biometria, video mbikëqyrja)
10. A ka dhënë mendim DMDHP – ja në lidhje me këtë ligj?
11. A është marrë parasysh mendimi i DMDHP-së?

#### **Analiza e përgjigjeve të pyetjeve të përcaktuara me metodologjinë**

Rezultat e analizës që pyetjeve të përcaktuara me metodologjinë janë të prezantuara në dy mënyra:

1. Përgjigjet e pyetjeve si fakte, gjegjësisht, pohim ose mohim për atë se parimet për mbrojtjen e të dhënave personale janë respektuar dhe
2. Arsyetim i rregullshmërisë të materies për mbrojtje të të dhënave personale dhe udhëzime dhe propozime për pajtim të plotë të ligjeve të veçanta me Ligjin për mbrojtje të të dhënave personale.

Deri në momentin e përgatitjes së raportit, mendimet e dhëna nga ana e DMDHP-së për pajtimin e ligjeve me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale nuk na u dorëzuan, prandaj ato nuk janë të përfshira në analizën juridike.

## Rezultatet e analizës juridike të ligjeve

Ligji	Regullimi i materies	Qëllimi	Vëllimi	Pëiqimi	Afati i ruajtjes	Masat teknike dhe organizative	Lidhshmëri me dispozita të tjera juridike	Përjashtime
Ligji dhe numri në Gazetën zyrtare (Ndryshimi ose plotësimi i fundit)	A parasheh ligji mbledhje të të dhënave personale dhe në çfarë forme (evidencë, regjistrë, bazë)	Për çfarë qëllimi është paraparë mbledhja e të dhënave personale dhe a është i qartë ky qëllim?	A i përgjigjet qëllimit vëllimi i të dhënave që përpunohen?	A është paraparë përqim nga subjekti për përpunimin e ndonjë kategorie të të dhënave personale?	A janë paraparë afate të qarta dhe konkrete për ruajtjen e të dhënave personale?	A ekziston nën i veçantë për mbrojtjen e të dhënave personale i cili tregon qartë aplikimin e masave teknike dhe organizative?	A duhet të jetë i lidhur edhe me aplikim të ndonjë ligji tjetër përpunimi i të dhënave i paraparë me këtë ligji?	A ekzistojnë përjashtime për përpunim të të dhënave të ndjeshme personale? (NVAQ, biometria, video mbikëqyrja)
Ligji për supervizion të sigurimit	✓	✓	✓	⊗	✓	⊗	✓	✓
Ligji për sigurim të detyrueshëm në komunikacion	✓	✓	⊗	⊗	✓	⊗	✓	✓
Ligji për sigurim pensional dhe invalidor	✓	✓	✓	⊗	✓	⊗	✓	✓
Ligji për sigurim shëndetësor	✓	✓	✓	⊗	⊗	✓	✓	✓
Ligji për evidencë në sferën e shëndetësisë	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Ligji për mbrojtje shëndetësore	✓	✓	✓	⊗	✓	✓	✓	✓
Ligji për mbrojtje të të drejtave të pacientëve	✓	✓	✓	✓	⊗	⊗	✓	✓
Ligji për siguri në komunikacionin rrugor	✓	✓	⊗	⊗	⊗	⊗	✓	✓
Ligji për sigurinë dhe shëndetin në punë	✓	✓	✓	⊗	⊗	⊗	✓	✓
Ligji për marrëdhëniet e punës	✓	✓	✓	⊗	✓	✓	✓	✓
Ligji për evidencë në sferën e punës	✓	✓	✓	⊗	✓	✓	✓	✓
Ligji për punësim dhe sigurim në rast të papunësisë	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Ligjin për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital	✓	✓	✓	⊗	✓	⊗	✓	✓
Ligji për nëpunësat shtetëror	✓	⊗	⊗	⊗	⊗	⊗	✓	⊗
Ligji për nëpunësat publik	✓	⊗	⊗	⊗	⊗	⊗	✓	⊗
Ligji për banim	✓	✓	✓	✓	✓	⊗	✓	✓
Ligji për kadastrë të patundshmërie	✓	✓	✓	⊗	⊗	✓	✓	✓
Ligji për librat amë	✓	✓	✓	⊗	⊗	⊗	✓	✓
Ligji për arsimin fillor	✓	✓	✓	⊗	✓	✓	✓	✓

Ligji	Rregullimi i materies	Qëllimi	Vëllimi	Pëllqimi	Afati i ruajtjes	Masat teknike dhe organizative	Lidhshmëri me dispozita të tjera juridike	Përfashtime
Ligji dhe numri në Gazetën zyrtare (Ndryshimi ose plotësimi i fundit)	A parasheh ligji mbledhje të të dhënave personale dhe në çfarë forme (evidencë, regjistrë, bazë)	Për çfarë qëllimi është paraparë mbledhja e të dhënave personale dhe a është i qartë ky qëllim?	A i përgjigjet qëllimit vëllimi i të dhënave që përpunohen?	A është paraparë pëllqimi nga subjektë për përpunimin e ndonjë kategorie të të dhënave personale?	A janë paraparë afate të qarta dhe konkrete për ruajtjen e të dhënave personale?	A ekziston nën i veçantë për mbrojtjen e të dhënave personale i cili tregon qartë aplikimin e masave teknike dhe organizative?	A duhet të jetë i lidhur edhe me aplikim të ndonjë ligji tjetër përpunimi i të dhënave i të dhënave i paraparë me këtë ligj?	A ekzistojnë përfashtime për përpunim të të dhënave të ndjeshme personale? (NVAO, biometria, video mbikëqyrja)
Ligji për arsimin e mesëm	✓	✓	✓	✗	✗	✗	✓	✓
Ligji për arsimin e lartë	✓	✓	✓	✗	✓	✓	✓	✓
Ligji për arsimin e të rriturve	✓	✓	✗	✗	✗	✗	✗	✗
Ligji për Regjistrin e veçantë për personat e dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm për veprat penale për abuzim seksual të personave të mitur dhe për pedofili	✓	✓	✓	✗	✗	✗	✓	✓
Ligji për mbrojtje sociale	✓	✓	✓	✗	✗	✓	✓	✓
Ligji për lojërat e fatit dhe lojërat zbatimëse	✓	✓	✓	✗	✗	✗	✓	✗
Ligji për energjetikën	✓	✓	✓	✗	✓	⊗	✓	✓
Ligji për administrimin e procesimit të lëndëve nëpër gjykata	✓	✓	✓	✗	✓	✓	✓	✓
Ligji për përmbartim	✓	✓	✓	✗	✗	✓	✓	✓
Ligji për procedurën kontestimore	✓	✓	✓	✗	✓	✗	✗	✓
Ligji për qarkullimin pagesor	✓	✓	⊗	✗	✓	✗	✗	⊗
Ligji për medie	✗	✗	✗	✗	✗	⊗	✗	✗
Ligji për procedurën tatimore	✓	✓	✗	✗	✗	✓	✓	✓
Ligji për parandalimin e larges së parave dhe financimin e terorizmit	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Ligji për bankat	✓	✓	✗	✗	✗	⊗	✓	✓
Ligji për komunikimet elektronike	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓

✓ I plotëson plotësisht kriteret e analizës

✗ Nuk i plotëson kriteret e analizës


✓ Në përgjithësi i plotëson kriteret e analizës, por me disa vërejtje (shiko Rekomandime për ligjin)

⊗ Nuk i plotëson kriteret e analizës, edhe pse në një pjesë të caktuar ato janë plotësuar

## Pasqyrë grafike e rezultateve të analizës juridike të 35 ligjeve të analizuara:

### Vëllimi


A i përgjigjet qëllimit vëllimi i të dhënave që përpunohen?



Vëllimi, gjegjësisht shtrirja e të dhënave personale që mbliidhen në masë të madhe është adekuat.

### Kontrollues


Kush i mbledh të dhënat fillimisht? (kompania, institucioni)



Si kontrollues më i shpeshtë paraqiten institucionet shëndetësore, pastaj Fondi i sigurimit pensional dhe invalidor, FSSHIM, punëdhënësi dhe Agjensioni për punësim i Republikës së Maqedonisë.

## Pëlqimi


A është paraparë pëlqim i subjektit për përpunimin e ndonjë kategorie të të dhënave personale?



Në një numër të vogël ligjesh që u analizuan parashihet kërkitimi i pëlqimit nga subjektet.

## Masat teknike dhe organizative

A ekziston nen i veçantë për mbrojtjen e të dhënave personale i cili na tregon qartë aplikimin e masave teknike dhe organizative?



Ky nen nuk implementohet në më shumë se gjysmën e ligjeve të analizuara.

# REKOMANDIME NGA HULUMTIMI

## Rekomandime sipas fushave

Gjatë përgatitjes së analizës juridike të ligjeve, hasëm në mangësi tipike në drejtim të mbrojtjes të të dhënave personale sipas fushës që i përkisnin ligjet e caktuara. Pastaj, krahas rekomandimeve për secilin ligj në veçanti që ishte objekt i analizës, i veçojmë edhe rekomandimet vijuese sipas fushave:

### 1. SIGURIMI

Në përgjithësi, në fushën e sigurimit nevojitet definim preciz i kategorive të të dhënave personale të të siguruarve që mbledhen për qëllim të sigurimit, duke filluar nga futja e numrit të amzës në Ligjin për supervizion të sigurimit deri tek futja e të dhënave personale shëndetësore të mbledhura për Kartelën elektronike shëndetësore në Ligjin për sigurim shëndetësor. Definim preciz i kategorive të të dhënave personale gjithashtu duhet të bëhet edhe në Ligjin për sigurim të detyrueshëm në komunikacion, Ligjin për sigurim pensional dhe invalidor dhe Ligjin për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital.

Futja e dispozitave për obligimin e miratimit të akteve dhe aplikimit të masave teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale në Ligjet e fushës së sigurimit është e nevojshme jo vetëm nga aspekti i rregullimit të brendshëm të punës së kontrolluesve, por edhe nga aspekti i arritjes së marrëveshjeve me Përdoruesit, marrjes të të dhënave nga subjektet e tjera dhe mbajtjes së evidencave për këto përpunime.

Afatet për ruajtje të të dhënave personale në ligjet e fushës së sigurimit nuk janë të përcaktuara në mënyrë precize për të gjitha evidencat. Diku, afatet janë të definuara me periudhë më të shkurtër të ruajtjes që nuk është në pajtim me LMDHP, sepse afati duhet të jetë i caktuar në mënyrë precize.

### 2. SHËNDËTËSIA

Nga analiza e Ligjit për evidenca në fushën e shëndetësisë, Ligjit për sigurim shëndetësor dhe Ligjit për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve, mund të konstatohet se mbi azhurnimin, ruajtjen, mbledhjen dhe disponimin me dokumentacionin shëndetësor aplikohen dispozitat e rregullave nga fusha e evidencave nga fusha e shëndetësisë, mbrojtjes të të drejtave të pacientëve dhe mbrojtjes së të dhënave personale. Duke marrë parasysh situatën e aplikimit të kësaj dispozite në praktikë, nevojitet definim i obligimit të secilit institut shëndetësor për të miratuar dhe aplikuar masa teknike dhe organizative për fshehtësi dhe mbrojtje të të dhënave personale.

Afatet e ruajtjes së të dhënave personale në ligjet nga fusha e shëndetësisë nuk janë përcaktuar në mënyrë precize për të gjitha evidencat. Është e nevojshme të precizohen afatet për ruajtje të të dhënave personale.

### 3. MARRËDHËNIET E PUNËS

Sipas Ligjit të sigurisë dhe shëndetit në punë, Ligjit për marrëdhëniet e punës, Ligjit për evidenca në fushën e punës dhe Ligjit për punësim dhe sigurim në rast të papunësisë, të dhënat personale që përpunohen janë në vëllim adekuat për qëllimin për të cilin janë mbledhur fillimisht. Kategoritë e të dhënave personale janë të përcaktuara detalisht për secilën evidencë në veçanti, por përsëri praktika na tregon për mbledhje të fotokopjes së letërnjoftimit në shumicën e evidencave, gjë kjo që nuk është e paraparë me këtë ligj dhe që nuk është në pajtim me parimet për mbrojtjen e të dhënave personale.

Plotësime dhe precizime të caktuara duhet të bëhen në Ligjin për siguri gjatë punës në pjesën e definimit të mënyrës së dorëzimit të raporteve nga institucionet shëndetësore deri tek punëdhënësi. Praktika na tregon për raste në të cilat raportit i përgjithshëm nuk është i ndarë nga rezultatet e kontrollit të kryer.

Në pjesën e definimit dhe aplikimit të masave teknike dhe organizative për fshehtësi dhe mbrojtje të të dhënave personale, është e nevojshme përcaktim i qartë i detyrimit të punëdhënësit për mbajtjen e rregulloreve për mbrojtje të të dhënave personale të punonjësve dhe subjekteve të tjerë lidhur me të dhënat personale.

Edhe pse një pjesë e të dhënave për kontakt të punonjësve që mblidhen mund të jenë zgjedhore, si për shembull përkatësia etnike e cila duhet të jetë e dhënë të cilën punonjësi do ta japë në mënyrë zgjedhore, ligji nuk parasheh pëlqim të subjektit në asnjë moment. Është e nevojshme që të jetë i paraparë pëlqimi i punonjësit.

Evidencat për punonjësit dhe evidencat për rroga ruhen në afat të gjatë, por për evidencat e tjera që përmbajnë të dhëna personale nevojitet lidhje me ligjin për punë arkivore.

### 4. BANIMI

Vëllimi i të dhënave personale që përpunohen sipas Ligjit për banim është adekuat me qëllimin, por praktika tregon për publikim të vëllimit më të madh të të dhënave në tabelat e shpalljes nëpër ndërtesa – Në Ligjin për banim nuk ekziston dispozitë e cila parasheh publikim të listës së banorëve me emër dhe mbiemër të cilët nuk kanë paguar mirëmbajtje të rregullt, dhe me këtë ky përpunim llogaritet si tepër i vëllimshëm në raport me qëllimin që duhet të arrihet.

Afati i ruajtjes së të dhënave është i paraparë vetëm për video mbikëqyrjen – 30 ditë. Është e nevojshme të precizohen edhe afatet e ruajtjes të të dhënave të tjera personale.

Edhe pse është e paraparë përshtatje me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, nuk ka nen i cili tregon për obligimin e bashkësisë të banorëve për rregullimin e brendshëm të masave teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale.

Sa i përket Ligjit për kadastër të patundshmërive, nevojitet përcaktim i precizuar i kategorive të të dhënave që mblidhen në SIGJ.

Afatet për ruajtje të të dhënave personale të mbledhura duhet të jenë të definuara saktë.

## 5. ARSIMI

Sipas Ligjit për arsim fillor, Ligjit për arsim të mesëm, Ligjit për arsim të lartë dhe Ligjit për arsim të të rriturve, pëlqimi i subjekteve të të dhënave personale nuk është i paraparë për të dhënat personale që nuk janë të parashtruara në kategoritë e të dhënave, dhe të cilat në praktikë mblidhen, gjegjësisht, i përmban (të dhëna shëndetësore, grupi i gjakut, numri i amzës të prindit) softveri (EMIS). Pëlqimi për përpunimin e këtyre të dhënave duhet të jetë i paraparë, si edhe mundësitë softverike për qasje në to.

Dispozita me të cilën definohet se shkolla e mesme mbledh, përpunon, ruan, dërgon dhe shfrytëzon të dhëna të vendosura në përmbledhjet e të dhënave sipas dispozitave për mbrojtjen e të dhënave personale, për nevojat e bazës së integruar të të dhënave të cilën e mban Ministria nuk është e qartë në pjesën e dërgimit të të dhënave. Duhet të definohet se ku mund të dërgohen të dhënat dhe sipas cilave kushte.

Për të gjitha ligjet e parashtruara nevojitet definim i të gjithë afateve për ruajtje të të dhënave personale dhe futje e një neni për mënyrën e mbrojtjes të të dhënave personale siç është rregulluar me Ligjin për arsimin fillor.

Në Ligjin për arsim të të rriturve nuk janë të definuara kategoritë e të dhënave personale që do të përpunohen për subjektet. Edhe pse është e paraparë mbajtja e dokumentacionit dhe evidencës, kategoritë nuk janë të parapara. E vetmja që tregon neni është se përmbajtjen dhe formën e dokumentacionit dhe evidencës me propozim të Qendrës e cakton ministri, që nuk është në pajtim me parimet për mbrojtjen e të dhënave personale.

## 6. ÇËSHTJET SOCIALE

Nga analiza e Ligjit për Regjistrin e veçantë për personat e dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm për veprat penale për abuzim seksual të personave të mitur dhe për pedofili rrjedh se qëllimi i përpunimit të të dhënave personale është sigurimi i mbrojtjes së fëmijëve nga keqtrajtimi seksual, pedofilia dhe tregtia me të mitur nëpërmjet të disponueshmërisë së informatave për personat që jetojnë në rrethin e tyre, e të cilët janë të dënuar për vepra penale lidhur me keqtrajtimin seksual të të miturve, pedofili dhe tregti me persona të mitur.

Qëllimi i vendosur në këtë mënyrë nuk është në pajtim me parimet e mbrojtjes të të dhënave personale nga aspekti i disponueshmërisë së informatave. Praktika në shtetet ku është vendosur regjistër i tillë është që qasja në të të jetë e kufizuar, gjegjësisht qasje në këto regjistra kanë çerdhet, shkollat, strehimoret për fëmijë, konviktet.

Vëllimi i të dhënave që përmban Regjistri do të ishte i përshtatshëm nëse qasja është e kufizuar. Në këtë rast, nëse regjistri është i disponueshëm për publikun duhet bërë një zvogëlim i vëllimit të të dhënave personale (inicialet, viti i lindjes, rruga e banimit).

Ajo që është në kundërshtim me parimet e mbrojtjes të të dhënave personale është që heqja nga regjistri publik bëhet me kërkesë të personit. Kontrolluesi duhet t'i heqë të dhënat pas kalimit të afatit, pa marrë parasysh se a ka kërkuar ose jo një gjë të tillë vetë personi.



Sa i përket Ligjit për mbrojtje sociale, nevojitet futje e një neni me të cilin do të parashihet aplikimi i masave teknike dhe organizative për fshehtësi dhe mbrojtje të të dhënave personale dhe definim të afateve për ruajtjen e të dhënave personale të mbledhura për qëllimet e këtij ligji.

## **7. LOJAT E FATIT**

Nevojitet definim i afateve për ruajtjen e të dhënave personale për secilën evidencë në veçanti.

Nevojitet futja e një neni me të cilin do të parashihet aplikimi i masave teknike dhe organizative për fshehtësi dhe mbrojtje të të dhënave personale.

## **8. INSTITUCIONE DHE NDËRMARRJE PUBLIKE DHE SHTETËRORE**

Sa i përket Ligjit për energjetikë, nevojitet definim i detyrimeve të operatorëve për miratimin e rregullave për aplikim të masave teknike dhe organizative për fshehtësi dhe mbrojtje të të dhënave personale të shfrytëzuesve.

Nevojitet qartësim i dispozitës e cila i referohet vëllimit të të dhënave personale që mblidhen. Vëllimi është i përshtatshëm përveç se në pjesën e mbështetjes me provë për identifikim personal. Formulimi i këtillë lejon interpretim të dyfishtë dhe lejon hapësirë edhe për mbajtjen e fotokopjeve të dokumenteve personale, që nuk është në pajtim me parimet për mbrojtjen e të dhënave personale.

Nevojitet definim i afateve për ruajtjen e të dhënave personale për secilën evidencë në veçanti.

Nevojitet futja e një neni me të cilin do të parashihet aplikimi i masave teknike dhe organizative për fshehtësi dhe mbrojtje të të dhënave personale.

Sa i përket Ligjit për nëpunës publik shtetërorë dhe Ligjit për nëpunës publik, përveç se që parashihet Regjistër i nëpunësve si përmbledhje e të dhënave personale, nuk është e definuar se cilat të dhëna personale do të përpunohen dhe as në cilën mënyrë do të kryhet përpunimi. Gjithashtu nuk janë të paraparë afate për ruajtjen e të dhënave. Tek këto dy ligje duhet të bëhen ndryshime dhe plotësime sipas të gjithë parimeve për mbrojtjen e të dhënave personale.

## **9. MEDIET**

Materia që e rregullon ky ligj është specifike dhe nga aspekti i aplikimit të parimeve për mbrojtjen e të dhënave personale nuk është i mundur definim preciz i të gjithë të dhënave për personat për të cilët raportohet ose personat e lidhur me to. Megjithatë, është e nevojshme të definohen drejtime të sakta për publikimin e të dhënave personale të personave për të cilët raportohet. Me këtë njëherit do të vendoseshin edhe standarde për përpunim të drejtë të të dhënave personale të cilët do të nënkuptonin vendosjen e masave teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale nga ana e medias.

Pëlqimi i subjektit gjithashtu duhet të parashihet me këtë ligj.

## 10. BANKAT

Ndryshim i dispozitës me të cilën parashihet: të dhënat i jepen Ministrisë për punë dhe politikë sociale, Agjencionit për punësim të Republikës së Maqedonisë dhe Fondit për sigurim shëndetësor të Maqedonisë, për nevojat e kryerjes së punëve që janë në kompetencat e tyre dhe në pajtim me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale, vetëm nëse banka lidh memorandum për bashkëpunim me këto institucione, me të cilin rregullohet mënyra e disponueshmërisë të të dhënave. Para së gjithash, është e diskutueshme vetë qasja si aktivitet dhe pastaj edhe baza e cila atë e lejon.

Nënshkrimi i paraparë i Memorandumeve për bashkëpunim me institucionet për marrjen e të dhënave është i diskutueshëm sepse Memorandumi nuk e ka atë fuqi ligjore të lejojë diçka të tillë, ai nuk është dokument në bazë të të cilit ato më të prekurit – qytetarët mund të realizojnë të drejtat ose të ankohen. Kjo e vë në pikëpyetje seriozitetin e bankave, veçanërisht për shkak të faktit që fshehtësia bankare më nuk është fshehtësi, por me përjashtime të caktuara, fshehtësia u zbulohet institucioneve.

Sa i përket rregullimit të qarkullimit pagesor, në bazë të ligjit, instrumentet pagesore dhe formën dhe përmbajtjen e tyre, përveç formës së instrumenteve pagesorë që i përmbajnë mediumet për transfer, i cakton ministri i financave. Me këtë formulim, përmbajtja e instrumenteve pagesore lihet të përcaktohet me Rregullore që nuk është në pajtim me parimet për mbrojtje të të dhënave personale.

Praktika tregon se për pagesat nga personat fizikë, në instrumentin pagesor është i përfshirë edhe numri i amzës pa pasur bazë ligjore për këtë.

## 11. GJYQËSIA, PËRMBARIMI PROCEDURA KONTESTIMORE

Ligji për procedurën kontestimore përmban dispozitë me të cilën definohet vëllimi i të dhënave personale. Qëllimi është i përshtatshëm përveç se në pjesën e mbështetjes me provë për identifikim personal. Ky formulim lejon interpretim të dyfishtë, dhe lejon hapësirë edhe për mbajtjen e fotokopjeve të dokumenteve personale që nuk është në pajtim me parimet për mbrojtjen e të dhënave personale.

Tek ky ligj, në mënyrë plotësuese duhet të intervenohet edhe në përcaktimin e afateve për ruajtjen e të dhënave personale për secilën evidencë në veçanti dhe masave teknike dhe organizative për fshehtësi dhe mbrojtje të të dhënave personale.

Vëllimi i të dhënave personale i paraparë me Ligjin për përmbarim është i përshtatshëm me qëllimin me vërejtjen e vetme se nuk është i precizuar saktë vëllimi i të dhënave për personat për të cilët Përmbaruesi jep shpallje publike. Shpesh në shpalljen është i përfshirë edhe numri i amzës, ndërsa për këtë nuk ka bazë ligjore.

Është e nevojshme të bëhet definimi i afateve për ruajtjen e të dhënave personale për secilën evidencë në veçanti si dhe futja e një neni me të cilin do të parashihet aplikimi i masave teknike dhe organizative për fshehtësi dhe mbrojtje të të dhënave personale.

## 12. SIGURIA

Kategoritë e të dhënave personale që përpunohen në evidencat e Ligjit për siguri në rrugë janë të definuara me ligje të tjera dhe me rregullore të Ministrisë së punëve të brendshme. Një evidencë për të cilën doemos nevojitet një rregullim i plotë i vëllimit të të dhënave është evidenca e regjistrimeve nga video mbikëqyrja e rrugëve.

Duke pasur parasysh faktin që video regjistrimi është materie e cila rregullohet me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, nevojitet përshtatje me parimet e kryerjes së drejtë të video mbikëqyrjes. Qëllimi është i qartë dhe i arsyeshëm, por nevojitet precizim i të dhënave personale që do të mblidhen (fokusi i regjistrimit të kamerave), cili person në Polici do të ketë qasje tek materialet e regjistruara, në cilën mënyrë do t'i dërgohen shoferit/ pronarit të automjetit. Gjithashtu, ligji duhet të parashohë edhe lajmërimet të veçanta për shoferët për vendet ku janë vendosur sisteme për video mbikëqyrje.

Nevojitet precizim i afateve, përveç tek regjistrimet e video mbikëqyrjes për të cilat është e paraparë se do të ruhen për afat prej 6 muajsh.

Ligji nuk përmban nen për mbrojtje të të dhënave personale, prandaj nevojitet që të futet një pjesë e veçantë për mbrojtje të të dhënave personale, gjegjësisht, për masat teknike dhe organizative që do të garantojnë fshehtësi dhe mbrojtje të të dhënave personale.

# PROCEDURA PËR DENONCIMIN E KEQPËRDORIMIT TË TË DHËNAVE PERSONALE DHE SHKELJES TË TË DREJTËS TË PRIVATËSISË

Çfarë të bëni nëse mendoni se është shkelur e drejta Juaj e privatësisë, ose se janë keqpërdorur të dhënat Tuaja personale?

Në fillim, mund të bëni kërkesë drejtuar Drejtorisë për mbrojtjen e të dhënave personale (DMDHP) – **Kërkesë për vërtetim të shkeljes të të drejtës për mbrojtje të të dhënave personale**. Më tej Drejtoria mund t'Ju kontaktojë për procedim të kërkesës tuaj.

Nëse e drejta Juaj e privatësisë është shkelur, ose është bërë keqpërdorim i të dhënave Tuaja personale nga ndonjë kompani ose institucion, ju **shumë lehtë dhe pa pagesë** mund të ngrini iniciativë për kryerjen e mbikëqyrjes inspektoriale nga ana e DMDHP, dhe atë:

E plotësoni formularin – **Iniciativë për kryerjen e mbikëqyrjes inspektoriale**. E gjitha që duhet të bëni është ta përshkruani problemin Tuaj.

1. Në formular në fillim plotësoni emrin, gjegjësisht emrin dhe mbiemrin e kontrollorit që i ka keqpërdorur të dhënat Tuaja personale, ose për të cilin keni njohuri se ka vepruar në kundërshtim me Ligjin për mbrojtje të të dhënave personale.
2. Pastaj, shkurt, përshkruani se në çfarë konsiston kjo shkelje dhe tregoni se çfarë veprimesh keni ndërmarrë deri më tani dhe nëse keni marrë përgjigje nga kontrollori për rastin konkret.
3. Bashkëngjitni kopje të shkresave mes Jush dhe kontrollorit, si dhe dëshmi të tjera që i keni. Nëse keni në plan që formularin ta plotësoni në formë elektronike, dëshmitë e provat që i keni më parë skenoni e pastaj bashkëngjitjani dokumentit (attachment).

Formularin e plotësuar në mënyrë elektronike mund ta dërgoni në këtë adresë: **info@privacy.mk**

Nëse nuk kemi mundësi që formularin ta dërgoni në mënyrë elektronike, atëherë printojeni atë dhe dorëzoheni në arkivin e Drejtorisë për mbrojtjen e të dhënave personale me postë në adresë bulevardi Goce Dellçev, nr. 18, 1000 Shkup. (Drejtorja për mbrojtjen e të dhënave personale ndodhet në objektin e Radio Televizionit të Maqedonisë).

## Sa zgjat procedura e mbikëqyrjes inspektoriale?

Afati për veprim pas iniciativës është përcaktuar në Ligjin për mbrojtje të të dhënave personale. Inspektori i dorëzon kontrollorit procesverbal në afat kohor prej 30 ditësh nga dita e përfundimit të mbikëqyrjes inspektoriale. Kontrollori ka të drejtë të japë vërejtje për procesverbalin në afat kohor prej 3 ditësh. Pak përfundimit të këtyre afateve, inspektori merr vendim për mënjanimin e shkeljeve të vërtetuara. Drejtoria për mbrojtjen e të dhënave personale do e njoftojë parashtruesin e kërkesës për rezultatet e procedurës.

## ANEKSE

### Aneksi 1:

#### Aneksi 1: Pyetësori për pjesëmarrësit në intervistë

1. A parasheh mbledhje të të dhënave personale dhe në çfarë forme (evidencë, regjistër, bazë të të dhënave) ligji mbi bazë të të cilit punoni?

Ligji (shëno) \_\_\_\_\_

evidencë                  regjistër                  bazë                  nuk parasheh

2. A është i qartë qëllimi për të cilin është paraparë mbledhja e të dhënave personale?

Po                                  Jo

3. A i përshtatet vëllimi i të dhënave personale qëllimit për të cilin ato mbledhen?

Po                                  Jo

4. Kush i mbledh të dhënat? (emri i kompanisë, institucionit)

\_\_\_\_\_

5. A ka të drejtë qasjeje në këto të dhëna ndonjë subjekt tjetër, gjegjësisht a i jepni për përdorim ose përpunim tek ndonjë institucion, kompani tjetër?

Po                                  Jo

6. A është paraparë pëlqim nga subjekti për përpunim të ndonjë kategorie të të dhënave personale? Nëse po, për cilën kategori bëhet fjalë?

Kategoria/kategoritë: \_\_\_\_\_

Nuk është paraparë pëlqim

7. Дали во законот врз основа на кој Вие работите се предвидени јасни и конкретни рокови за чување на личните податоци?

Po                                  Sa vite ose muaj? \_\_\_\_\_

Jo

8. A ekziston ndonjë nen i veçantë për mbrojtjen e të dhënave personale i cili thekson qartë aplikimin e masave teknike dhe organizative?

Po                                  Jo

9. A keni miratuar Ju akte interne për masa teknike dhe organizative për fshehtësi dhe mbrojtje të të dhënave personale?

Po                                  Jo

10. A është paraparë me këtë ligj përpunimi i të dhënave, apo duhet të përfshihet dhe zbatohet me një ligj tjetër?

Овој закон                  Me një ligj tjetër

11. A ka përjashtime për përpunim të të dhënave personale delikate?  
(NVPQ, biometria, mbikëqyrja video)

Po

Psh. \_\_\_\_\_

Nuk ka përjashtim.

12. A ka dhënë mendimin e saj DMDHP në lidhje me ligjin dhe a është marrë parasysh ai mendim?

Po, është marrë par.

Po, por nuk është marrë par.

Jo

## Aneksi 2.

### Lista e ligjeve të analizuara me radhitje sipas alfabetit

Versionet e konsoliduara të të gjitha ligjeve të analizuara, në fuqi në kohën e shqyrtimit, mund t'i gjeni në pjesën „Biblioteka “ në faqen e internetit „Privatnost“

<http://privatnost.mk/biblioteka-na-zakoni/>.

Ligji mbi procedurën kontestimore  
Ligji për arsimin e lartë  
Ligji për arsimin e mesëm  
Ligji për arsimin e të rriturve  
Ligji për arsimin fillor  
Ligji për banim  
Ligji për bankat  
Ligji për energjetikë  
Ligji për evidencë nga sfera e punës  
Ligji për evidencë nga sfera e shëndetësisë  
Ligji për kadastër të patundshmërive  
Ligji për komunikimet elektronike  
Ligji për librat amë  
Ligji për lojërat e fatit dhe lojërat zbavitëse  
Ligji për marrëdhëniet e punës  
Ligji për mbrojtje shëndetësore  
Ligji për mbrojtje sociale  
Ligji për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve  
Ligji për mediumet  
Ligji për menaxhimin e qarkullimit të lëndëve në gjykata  
Ligji për nëpunësat publik  
Ligji për nëpunësat shtetëror  
Ligji për parandalimin e larjes së parave dhe financimin e terrorizmit  
Ligji për pedofili  
Ligji për procedurën tatimore  
Ligji për punësim dhe sigurim në rast të papunësisë  
Ligji për përmbarrim  
Ligji për qarkullim pagesor  
Ligji për siguri në komunikacionin rrugor  
Ligji për sigurim pensional dhe invalidor  
Ligji për sigurim shëndetësor  
Ligji për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital  
Ligji për sigurimin e detyrueshëm në komunikacion  
Ligji për sigurinë dhe shëndetin në punë  
Ligji për supervizion të sigurimit

## Literatura e përdorur

- Council of Europe, Office of Treaties, <http://conventions.coe.int/>
- Electronic Privacy International Center (EPIC), [www.epic.org](http://www.epic.org)
- EPIC, (2004), Privacy & Human Rights – An International Survey of Privacy Laws and Developments, United States of America
- EPIC, (2006), Privacy & Human Rights – An International Survey Of Privacy Laws And Developments, United States of America
- Privacy International, EPIC, CMCS, (2010), European Privacy and Human Rights (EPHR) 2010, <http://goo.gl/xzHv80>
- Akademika, përmbjedhe elektronike e rregulloreve në fuqi, <http://www.akademika.com.mk/>
- Drejtoria për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, [www.dzlp.mk](http://www.dzlp.mk)
- Të drejtat Digjitale Evropiane , <https://edri.org/theme/privacy/>
- Organi mbikëqyrës Evropian për mbrojtjen e të dhënave personale, [edps.europa.eu](http://edps.europa.eu)
- Kenig, Nikolina, (2008), Metoda kualitative për hulumtim, Fakulteti filozofik, Shkup
- Shqyrtim i Ligjit për të dhënat personale, (2010), Drejtoria për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Shkup
- Mini – hulumtim për shprehitë e fëmijëve gjatë kërkimit në internet, (2011), Fondacioni Metamorfozis, Shkup, <http://goo.gl/jbA5rj>
- Neuvirt, Karel, (2007), Privatësia si e drejtë themelore e njeriut, Fondacioni Metamorfozis, Shkup, <http://goo.gl/dmfHsb>
- Pravdiko, faqe interneti për arsimim në fushën e drejtësisë, [www.pravdiko.mk](http://www.pravdiko.mk)
- Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, <http://www.sobranie.mk/ustav-na-rm.nspix>







METAMORFOZIS 